



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:113195

Datë: 19.07.2024

Numri i dokumentit: 05958139

KA.nr.519/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit "PATRONI", NTSH me nr. biznesi 810703836 me seli në Malishevë, me përfaqësues te autorizuar Avokat Naim Spahiu me adrese Dëshmorët e Ponoshecit, Ish-Fabrika e Amortizatoreve- Terminal Doganor Zyra 6 Prishtine, kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Kryeinspektorati i Tregut, me kërkesëpadi për anulim të Vendimit Nr. Ref 19, datës 20.08.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 10.06.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadija e paditësit "PATRONI", NTSH me nr. biznesi 810703836 me seli në Malishevë, me përfaqësues te autorizuar Avokat Naim Spahiu me adrese Dëshmorët e Ponoshecit, Ish-Fabrika e Amortizatoreve- Terminal Doganor Zyra 6 Prishtine, kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Kryeinspektorati i Tregut, për anulim të Vendimit te Ministrisë së Tregtisë edhe Industrisë- Kryeinspektorati i Tregut Nr. Ref 19, dates 20.08.2020, **si e pa pabazuar.**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

### Historiku procedural

1. Me datë 14.09.2020, në Gjykatën Themelore ne Prishtine, Departmenti per çështje Administrative, Paditesi "PATRONI", NTSH me nr. biznesi 810703836 me seli në Malishevë, me përfaqësues te autorizuar Avokat Naim Spahiu me adrese Deshmorët e Ponoshecit, Ish-Fabrika e Amortizatoreve- Terminal Doganor Zyra 6 Prishtine, ka parashtruar padi, të evidentuar me nr. A.nr.1526/2020, kundër të paditurës Ministria e Tregtise dhe Industrise- Kryeinspektorati i Tregut, për anulim të Vendimit te Ministrise së Tregtise dhe Industrise- Kryeinspektorati i Tregut Nr. Ref 19, dates 20.08.2020.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 519/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik më datë 10.06.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Naim Spahiu avokat, sipas autorizimit të datës 18.05.2024, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur nga Avokatura Shtetërore, i ftuar në mënyrë të rregullt ku i njëjtit ftesën për seancë e ka pranuar më datë 27.05.2024, ndërsa gjykata më datë 10.06.2024 ka dorëzuar parashtrësë për deklaram me propozim që seanca të mbahet pa prezencë të përfaqësuesit të paditurës konform nenit 41 të LKA-së.

### Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar vendimin Nr. Ref 19, dates 20.08.2020, të nxjerrë nga e paditura, për shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave procedurale më arsyetim se nuk jane aplikuar drejt dispozitat ligjore (nga neni 16 pika 1.1 i LKA), konstatimit te gabuar dhe jo te plote gjendjes faktike (nga neni 16 pika 1.3 i LKA), dhe për shkak te aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me arsyetim se Ministria e Tregtise edhe Industrise- Kryeinspektorati i Tregut me vendimin me Nr. Ref.19 e dates 20.08.2020 ka refuzuar ankesën nr.4380 te dates 05/08/2020 e parashtruar nga personi

fizik i subjektit ekonomik N.T.SH "patroni" me NRB 80219504, njesia në Arbanë Prizren.

5. Konsideron se vendimi i kontestuar eshte i pabazuar dhe jo i ligjshem, sepse arsyetimi i vendimit eshte kontradiktor me vetveten dhe ne kundërthënie te plote me gjendjen faktike te konstatuar ne arsyetimin e vendimit. Inspektorati i Tregut me rastin e shiptimit te gjobes se larte cekur per shkak mos prezantimit te dokumentacionit perkates ne afatin e paraparë ligjor, nuk e ka marre per baze kohën e pandemisë për shkak të virusit COVID 19, ku Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur masa kufizuese, prandaj ka qenë a pamundur të plotësohet dokumentacionin e kërkuar. Për shkak të pandemisë Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka shtyer shlyerjen e obligimeve tatimore, kompania është përballur me situatë të vështirë financiare, prandaj nga kjo situatë nuk ka mundur të siguroj dokumentin që nuk kanë obligime tatimore.
6. Konsideron se vendimi i te paditures eshte marrë në shkelje te procedures administrative, perkatësisht te parimit te objektivitetit dhe te paanshmerise, pasi që nuk i eshte dhene peshe e duhur te gjitha fakteve ne lidhje me problematiken e kesaj lende dhe nuk eshte bere verifikimi i provave ne te cilat eshte mbeshtetur aktvendimi kontestues, gje qe eshte ne kundërshtim me nenin 89 të Ligjit per Proceduren e Pergjithshme Administrative. E paditura vendimin e vet nuk e ka arsyetuar fare, pasi qe arsyetimi i dhëne eshte i pergjithesuar dhe nuk eshte i formular qartë dhe nuk jep sqarime te bazes ligjore dhe faktike.
7. Prandaj i propozon gjykatës që ta aprovoj ne tërësi si te bazuar padinë e paditesit "PATRONI", NTSH, të anuloj vendimin e kundërshtuar si të paligjshem, dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqesore.

#### Kundërshtimet e të paditurës

8. E paditura Ministria e Tregtise dhe Industrise- Kryeinspektorati i Tregut, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, në përgjigje në padi e konteston ne tërësi si te pabazuar kerkesëpadine e paditesit "Patroni". Deklaron se të gjitha veprimet procedural dhe masat e ndermarra nga inspektorët e tregut, kanë qene brenda kompetencave te percaktuara me ligj, jane marre duke u bazuar ne gjendjen faktike dhe ne baze te dispozitave te

percaktuara me nenin 14 paragrafi 14.2 dhe 14.3 të Ligji Nr.03/L-181 per Inspektoratin dhe Mbikegyrjen e Tregut dhe sanksionohet me nenin 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 te Ligjit Nr.04/L-186 per Plotesimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-181 per Inspektoratin dhe Mbikegyrjen e Tregut.

9. I propozon gjykatës që kërkesëpadinë e paditesit "Patroni" NTSH me seli ne Malisheve ta refuzon në tërësi si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi i kundërshtuar.

#### Provat e administruara

10. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar me nr. Ref:19 me datë 20.08.2020 i nxjerrë nga I.T i M.T.I-së, Ankesë nga paditësi Patroni N.T.SH e dorëzuar tek kryeinspektori i I.T-së me datë 05.08.2020, Aktvendim me nr.Ref:19/2020 me datë 21.07.2020, Procesverbal me nr.19/0000559 me datë inspektimi 01.11.2020.
11. Nga provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Inspektori i tregut me vendimin nr.19 te datës 21/072020, personit fizik H.M. të subjektit ekonomik N.T.SH "Patroni", me NRB 80219504, njësia Arbanë Prizren, i kane shqiptuar gjobe ne vlere prej 500.00 € (pesëqind) euro. Parashtruesi i ankesës, i pakënaqur me aktvendimin e inspektorëve të tregut, me date 05/08/2020, ka parashtruar ankesën nr.4380, me te cilën kundërshton aktvendimin e inspektoreve te tregut të MTI-së.
12. Me Vendimin e Ministrise se Tregtisë dhe Industrisë- Kryeinspektorati i Tregut Nr.Ref.19, datës 20/08/2020, refuzohet ankesa nr.4380 e dates 05/08/2020, e parashtruar nga subjekti ekonomik N.T.SH "Patroni", me NRB: 80219504, njesia Arbanë Prizren, dhe mbetet në fuqi Aktvendimi nr.4109 i datës 13/10/2020, i nxjerr nga inspektorët e tregut të MTI-së, me arsyetim se Inspektorët e tregut te MTI-se, me rastin e ushtrimit te mbikëqyrjes inspektuese te subjekti Ekonomik N.T.SH "Patroni", njësia Arbanë Prizren, ne procesverbalin e inspektimit nr.19/001395 te dates 18/06/2020, kane konstatuar që personi pergjegjes i subjektit te inspektuar nuk ka prezantuar dokumentacionin e kerkuar nga inspektorët e tregut si: Licencën për shitje me pakicë për produktin Dizel dhe Benzine, Licencën për shitje me pakicë për të GLN-së, Faturat e furnizimit me produktet Dizel, Benzinë dhe GLN, me ç'rast me procesverbalin i është dhënë mundësia qe brenda

afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, te prezantoj dokumentacionin e kerkuar nga inspektorët e tregut. Personi pergjegjes i subjektit te inspektuar edhe pas afatit ligjor te dhene nuk ka prezantuar dokumentet e kerkuara nga inspektoret e tregut, duke vepruar ne kundërshtim me nenin 14 paragrafi 14.2, dhe 14.3 te Ligjit Nr.03/L-181 per Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut dhe sanksionohet me nenin 14, paragrafi 1 te Ligjit nr.04/L-186 për plotesim ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-181 per Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut. Kryeinspektori i inspektoratit te tregut ka vlerësuar që aktvendimi është brenda kompetencave te përcaktuara me dispozitat e nenit 14 të Ligjit për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, dhe sipas gjendjes faktike te konstatuar në Procesverbalin nr. 19/001395 të datës 18.06.2020 dhe masat ndëshkimore në bazë të dispozitave ligjore.

### Vlerësimi i gjykatës

13. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaramet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.
14. Në kuptim të Neni 27 par 4. Kundër aktvendimit të Kryeinspektorit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Gjykata vlerëson se Vendimi I Ministrise se Tregtise dhe Industrise- Kryeinspektorati i Tregut Nr.Ref.19, dates 20/08/2020, me të cilin refuzohet ankesa nr.4380 e dates 05/08/2020, e parashtruar nga subjekti ekonomik N.T.SH "Patroni", me NRB: 80219504, njesia Arbanë Prizren, dhe mbetet në fuqi Aktvendimi nr.4109 i datës 13/10/2020, i nxjerr nga inspektorët e tregut të MTI-së, është në përputhje me dispozitat ligjore me nenin 14 te Ligjit nr. 04/L-186 Per plotesim ndryshimin e ligjit nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikeqyrjen e Tregut, në paragrafin 1 përcaktohet: *Subjekti ekonomik, i cili i nënshtrohet inspektimit është i detyruar ti mundësojë inspektorit mbikëqyrjen inspektuese në pajtim me dispozitat e nenit 11 të këtij ligji.* Paragrafi 2 përcakton: *Subjekti ekonomik sipas kërkesës së inspektorit, është i detyruar që menjëherë t'i ofroi të dhënat e mundshme e të nevojshme, ndërsa për raste të shtyshme sipas vlerësimit, brenda afatit të përcaktuar nga inspektori.* Sipas paragrafi 3. *Subjekti ekonomik i cili mbikëqyret konsiderohet që nuk i ka mundësuar inspektorit kryerjen e mbikëqyrjes nga paragrafi 1. i këtij neni nëse edhe brenda afatit të*

*përcaktuar me procesverbalin e inspektorëve, nuk siguron qasje në produkte, dokumentacionin e kërkuar të punës dhe dokumente tjera të nevojshme për të konstatuar gjendjen faktike të mbikëqyrjes së filluar.*

15. Bazuar ne procesverbalin e inspektimit nr.19/001395 te dates 18/06/2020, me rastin e ushtrimit te mbikëqyrjes inspektuese te subjekti Ekonomik N.T.SH "Patroni", njësia Arbanë Prizren, nga Inspektoret e tregut te MTI-se, kane konstatuar se personi përgjegjës i subjektit te inspektuar nuk ka prezantuar dokumentacionin e kerkuar nga inspektorët e tregut si: Licencën për shitje me pakicë për produktin Dizel dhe Benzine, Licencën për shitje me pakicë për të GLN-së, Faturat e furnizimit me produktet Dizel, Benzinë dhe GLN, me ç'rast me procesverbalin i është dhënë mundësia qe brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, te prezantoj dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët e tregut.
16. Personi përgjegjës i subjektit te inspektuar edhe pas afatit ligjor te dhënë nuk ka prezantuar dokumentet e kërkuara nga inspektorët e tregut, duke vepruar ne kundërshtim me nenin 14 paragrafi 14.2, dhe 14.3 te Ligjit Nr.03/L-181 Per Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut dhe sanksionohet me nenin 14, paragrafi 1 te Ligjit nr.04/L-186 për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-181 per Inspektoratin dhe Mbikeqyrjen eTregut.
17. Prandaj gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar i të paditurës Ministria e Tregtise dhe Industrise- Kryeinspektorati i Tregut, për anulim të Vendimit te Ministrise së Tregtise edhe Industrise- Kryeinspektorati i Tregut Nr. Ref 19, dates 20.08.2020, është i drejte dhe i ligjshëm, i bazuar në konstatim të drejtë të gjendjes faktike. Po ashtu gjoba e shqiptuar është në përputhje me dispozitat ligjore ndëshkuese të përcaktuara me Ligjin 04/L-186 per plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikeqyrjen e Tregut. Neni 13 paragrafi 1 përcakton Inspektori i tregut për shkeljet e konstatuara me këtë ligj i shqipton gjobat në vijim: 1.1. me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, ndëshkohet personi juridik për shkeljet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit bazik. 1.2. me gjobë prej treqind (300) deri në nëntëqind (900)Euro, ndëshkohet personi përgjegjës i personit juridik për shkeljet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit bazik. 1.3. me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) Euro, ndëshkohet personi fizik. Prandaj gjoba e shqiptuar personit përgjegjës H.M. te Subjektit Ekonomik N.T.SH "Patroni" me NRB: 810703836, njesia Arbanë Prizren në shume prej

500.00 (pesëqind euro), si e tillë është e drejtë dhe e ligjshme dhe e bazuar në gjendjen faktike të konstatuar në Raportin e Inspektimit të datë 18.06.2020.

18. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzimet procedurale u bazua në nenin 63 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.519/22, datë 28.06.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.